

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Fall 9-2013

BENEFITET E AUDITIMIT

Rifadije Cakolli

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the Business Commons



Universiteti për Biznes dhe Teknologji
Departamenti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome
2010/2011

Rifadije Cakolli

BENEFITET E AUDITIMIT

Mentore: PHD.Cand. Bukurie Imeri- Jusufi

Shtator/2013
Prishtinë

Kypunim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelo

ABSTRAKT

Punimi do të trajtoj qështje që kanë të bëjnë me Procesin e Auditimit dhe po ashtu do të tregojmë rëndësin e Auditimit në përgjithësi. Në këtë temë do të shtjellojmë lëndën e hulumtimit, objektin dhe objektivat e auditimit, ku do të përfshijë llojet e modeleve të auditimit me të gjitha parimet e principeve sipas standardeve të pranuar ndërkombëtare, ku rëndësi të veçantë do të kushtojmë benefiteve dhe avantazheve të auditimit.

Ngritja dhe funksionimi i strukturave audituese në çdo njësi organizative si atyre të shpenzimeve të fondeve publike njashtu edhe private është jo vetëm kërkesë e standardeve, por domosdoshmëri që rrjedh nga roli i auditimit në përgjithësi për të vlerësuar sistemet e kontrollit dhe të qeverisjes, dhe për të mbështetur drejtuesit e subjekteve në përmbushjen e objektivave të tyre.

FALËNDERIME

Falëndërimet e mija më të sinqerta ia dedikoj mentorit të këtij punimi të diplomës Znj.Bukurie Imeri–Jusufi, për ndihmën e madhe të ofruar në zgjedhjen dhe definimin e temës, për udhëheqje profesionale gjatë punimit të temës, si dhe për kontribut të madh në konceptimin e duhur të temës dhe përfundimit të suksesëshëm të saj.

Ghithsesi i falëndërohem edhe gjithë kolegëve të mijë të cilët vazhdimisht më kanë përkrahur gjatë tri viteve të studimit dhe inkurajuar gjatë përgaditjes së këtij punimi.

Në fund, falëndërimet më të veçanta ia dedikoj familjes timë për sakrificën që kanë bërë në formimin tim si personalitet, si dhe për mbështetje morale e mirëkuptim.

PËRMBAJTJA

Lista e tabelave.....	IV
Lista e Termave	V
1.0 HYRJE.....	1
2.0 HISTORIKU.....	2
2.1 Zhvillimi historik I auditimit në botë	2
3.0 PËRKUFIZIMI I AUDITIMIT	4
3.1 Vështrimi mbi auditimin.....	4
4.0 OBJEKTI DHE LËNDA E AUDITIMIT	6
4.1 Objektivat e auditimit	8
4.2 Vlerësimi i nevojave për auditim.....	12
5.0 LLOJET E AUDITIMIT	16
Llojeve e auditimit	
5.1 Auditimi ekstern -Auditimi intern	15
5.2 Auditimi i pasqyrave financiare -Auditimi i afarizmit.....	16
5.3 Auditimi Komercial -Auditimi Shtetëror.....	18
5.4 Parimet e principeve të Auditimit.....	21
6.0 BENEFITET E AUDITIMIT	23
6.1 Auditorët e brendshëm.....	24
6.2 Auditorët e jashtëm.....	25
7.0 PËRFITIMET DHE AVANTAZHET E AUDITIMIT	26
8.0 DISKUTIME DHE PËRFUNDIME	28
9.0 REFERENCAT	30

LISTA E TABELAVE **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 1. Llojet themelore të auditimit.....14

LISTA E TERMAVE

CIA - Auditor Inter i Çertifikuar

CA - Kontabilist i Autorizuar

AICP - Instituti Amerikan i Kontabilistëve Publik të Çertifikuar

ICA - Instituti i Ekspertëve Kontabël

IW - Instituti i auditorit

INTOSAI - Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit

GAGAS - standardet e pranuarë përgjithësisht të auditimit të qeverisë

ISA 200 - Standardet ndërkombëtare të Auditimit

1 HYRJE

Një nga kërkesat kryesore të rritjes së cdo aktiviteti është dhe ndërtimi i një sistemi të shëndoshë qeverisjeje të po atyre institucioneve apo ndërmarrjeve,ku interesate të gjitha palëve të jenë mbrojtur në mënyrë të përshtatshme dhe këto institucione apo ndërmarrje të arrijnë të përmosojë vetveten në procesin përmbushjes së objektivave të saj .Auditimi është pa dyshim mjeti më i mirë për arritjen e këtij qëllimi.

Auditimi dhe auditorët e caktuar kanë qënë kohët e fundit një rol i ri në jetën tonë , si të themi një nga duart e padukshme të realitetit të biznesit dhe sfidat që janë vazhdimisht në ndryshim.

"Auditimi është një proces sistematik i objektivisht marrjen dhe vlerësimin e provave lidhur me pohimet rreth veprimeve ekonomike dhe ngjarje për të konstatuar shkallën e korrespondencës ndërmjet pohimeve dhe kritereve të përcaktuara dhe komunikimin e rezultateve për përdoruesit e interesuar"

Ky punim diplome përmbanë shqyrtimin,i cili do të ndihmojë në formulimin deri diku te një njohje më përsë afërmi me auditimin lëndën objektin rolin e auditimit,gjithashtu me një njohje mbi vëte përmbajtjen e auditimit benefitet,avantazhet dhe parimet qe përmban ky proces .

Duke u nisur nga fakti,se në lidhje me temën e auditimit (benefitet) ekzistojnë njohuri paraprake të marra si nga mediat po edhe vete ambientin që na rrethon, në organizatat ku punojmë,mendoj se një punim i përmbledhur është një mundësi hyrje në këtë temë

2 HISTORIKU

Zhvillimi historik i auditimit në botë

Historia zakonishtë mësohet në kontekstin e të kuptuarit në të mirë të të sotshmes dhe ndërtimit kualitativ të së ardhmes. Pikërisht për këtë, përvija historike nuk duhet nënqmuar. Shpesh theksohet se gjeja në auditim nuk kemi kurrfarë përvijash.

Shikuar historikisht, fillimet e auditimit gjenden në Egjiptin e Vjeter, Babiloni dhe Greqi. Është me rëndësi të theksohet se kjo ka të bëjë me auditimin e mbrendshëm. Zhvillimi i auditimit të jashtëm, në kuptimin e vertet të fjalës, fillon në fillim të shekullit XV, në Itali dhe lidhet me emrat e Bene Kotruleviqit dhe Luce Pacolit.

Së shpejti vjen deri te paraqitja e auditimit edhe në Angli. Konsiderohet se organizata e parë profesionale e auditorve shoqata e kontabilistëve është themeluar më 1581 në

Venedik. Zhvillimi më i shpejtë i auditimit fillon në Angli dhe kjo më 1853, kur është themeluar shoqata profesionale e auditorve (kontabilistave) e cila merr autorizimin mbretëror („Royal Charter”) për kryerjen e punëve të auditimit.

Më 1892 në Angli futet thirrja „Kontabilist i autorizuar” (Chartered Accountants) i cili ka mbetë deri në ditët e sotme.

Zhvillimi inteziv i auditimit në SHBA fillon më 1887, kur në shtetin New York është themeluar shoqata e parë amerikane e auditorve dhe atëherë futet thirrja „Kontabilist i autorizuar publik”.

Për zhvillimin e auditimit në Europë posaqërisht e rëndësishme është themelimi i lidhjes së auditorve të kontabilitetit në Berlin të Gjermanisë më 1896. Më 1931, në Gjermani futet thirrja hulumtuese (ekzaminator) ekonomik, dmth auditor (Wirtschaftsprüfer) i cili ekziston edhe sot.

Zhvillimi i veprimtarisë së auditimit është lidhur ngushtë me zhvillimin e ekonomisë së tregut dhe sigurisht nuk është e rastit që auditimi më i zhvilluar është në vendet siq janë: SHBA, Franca, Gjermania etj.

Për zhvillimin e auditimit të jashtëm me rendësi vendimtare ka qenë themelimi i instituteve nacionale të auditorëve të autorizuar, siq janë p.sh. „Amerikan Institute of Certified Public Accountants” AICP në SHBA, “The Institute of Chartered Accountants” ICA në Britani të Madhe, “Institute der Wirtschaftsprüfer” në Gjermani etj.

Vet zhvillimi historik ka kushtëzuar që në shtetet evropiane (përjashtim bëjnë Britania e Madhe dhe Holanda) ku në zbatimin e auditimit të jashtëm kujdes më të i kushtojnë harmonizimit me dispozita ligjore, ndërsa në Britani të Madhe dhe në SHBA rendësi më të madhe i kushtojnë respektimit të standardeve dhe parimeve të përcaktuara të kontabilitetit. Detyrat e auditimit duhet trajnuar në kontekstin e zhvillimit të tij historik. Me këtë rast është e rëndësishme të theksohet se në disa shtete ekzistojnë ndryshime të caktuara lidhur me pikpamjet mbi detyrat e auditimit dhe këto ndryshime janë më të mëdha lidhur me auditimin e mbrendshëm se sa për auditimin e jashtëm.¹

¹ Marrë nga ligjërata Dr. Hysen Ismajli, Auditimi 2010

3 PËRKUFIZIMI I AUDITIMIT

Auditimi është term administrativ me të cilin nënkuptohet procesi që mund të realizohet për të kënaqur kërkesat e menaxhimit, apo të ndonjë auditori tjetër të pavarur, për të plotësuar obligimet statusore.

Përkufizimi i përgjithshëm injë auditimi është një vlerësimi një personi, organizate, sistemit, procesit, ndërmarrje, projekti ose produkti. Termi më i zakonshëm referohet kontrolle në kontabilitet, auditimin e brendshëm, dhe auditimit të qeverisë, por konceptetë ngjashme ekzistojnë edhe në menaxhimin e projektit, menaxhimin të cilësisë, menaxhimin e ujit, dhe ruajtjes së energjisë.

Auditimi përkufizohet si një ekzaminim sistematik dhe i pavarur i të dhënave, deklaratave, shënimeve, operacioneve dhe shfaqjeve (financiare ose të ngjashme) të një ndërmarrjeje për një qëllim të caktuar. Në çdo auditim auditori percepton dhe pranon propozimet përpara tij për ekzaminim, mbledh prova, vlerëson një të dhëmbi këtë bazë formulon gjykimin e tij i cili komunikohet përmes raportit të tij të auditimit.

3.1 VËSHTRIM MBI AUDITIMIN

Auditimi është një pjesë jetike e kontabilitetit. Tradicionalisht, auditimet janë të lidhura kryesisht me fitimin e informacioneve në lidhje me sistemet financiare dhe të dhënat financiare të një kompanie apo të një biznesi.

Auditimet financiare kryhen për të vërtetuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e informacionit, si dhe të sigurojë një vlerësim të kontrollit të brendshëm të një sistemi.

Qëllimi i auditimit është të shprehim një opinion të sistemit person / organizate / (etj) në fjalë, sipas vlerësimit të bazuar në punën e bërë në bazë testimesh.

Një auditim duhet t'i përmbahet standardeve të pranuar përgjithësisht të vendosura nga organet qeverisëse. Këto standarde u sigurojnë palëve të treta ose përdoruesit e jashtëm që ata mund të mbështeten mbi opinionin e auditorit në lidhje me korrektësinë e pasqyrave financiare, apo subjekte të tjera mbi të cilat auditori shpreh një opinion.

"Auditimi është ekzaminimi i pavarur i informacionit financiar të çdo subjekti, nëse fitimi është i orientuar apo jo, dhe pavarësisht nga madhësia e tij apo forma ligjore, kur një ekzaminim i tillë është realizuar me synimin për të shprehur një opinion mbi të".²

²Gilbert W. Joseph and Terry J. Engle (December 2005).

["The Use of Control Self-Assessment by Independent Auditors".](#)

[^"Audit assurance".](#)

4 OBJEKTI DHE LËNDA E AUDITIMIT

Auditimi, shumë shkurtë mund të përshkruhet si metodë qëllimi i së ciles është sigurimi i informatave të besueshme për shfytëzues të ndryshëm.

Megjithatë, për auditimin është keq nëse ai shikohet vetëm nga aspekti i veprimit praktik, dmth. si grumbull i procedurave të zakonshme ose metodave të cilat zbatohen në auditim. Auditimi megjithatë është diq më tepër sepse, përveq rëndësisë së tij praktike, nënkupton edhe rëndësinë e tij shkencore dhe teorike. Me fjalë të tjera, zgjidhjet praktike të cilat zbatohen në auditim duhet të kenë bazë shkencore-teorike.

Marrë në përgjithësi, objektivi i auditimit është sikur edhe të disiplinat tjera mikroekonomike afarizmi me përjashtim që më së shpeshti theksi është në raportet financiare. Për këtë arsye, parashtrahet pyetja në çka ndryshon auditimi të kjo disiplinë në krahasim me disiplinat tjera që do disiplinë tjetër të njëjtin objekt e vështron në një mënyrë tjetër, nga një kënd tjetër, nga një pikëpamje tjetër.

Prandaj, të gjitha këto disiplina ndryshojnë prej auditimit sipas lëndës së hulumtimit, me përcaktimin e lëndës së auditimit krijohen supozimet bazë për ndryshimin e auditimit me disiplinat tjera për shembull: ekzistojnë pika takimi dhe lidhje të ngushta të auditimit dhe kontabilitetit, pastaj auditimit dhe analizës së afarizmit. Në këtë kontekst të dhënës me përcaktimin preciz të lëndës së auditimit mund të dallohet auditimi prej disiplinave tjera.

Qështja e objektit dhe lëndës së auditimit zakonisht nuk shqyrtohen në mënyrë eksplicite, por përcaktimi i tyre rrjedh prej vetë kuptimit të konceptit të auditimit. Siq është theksuar, nënkuptohet se auditimi është proces i sistemuar i objektivizuar i mbledhjes dhe krijimit të të dhënave mbi ndodhitë ekonomike dhe në rezultatet me qëllim që të hulumtohet dhe vlerësohet përputhshmëria në mes afarizmit ekzistues pastaj të raporteve financiare me kriteriumet e përcaktuara më parë.

Me raportet financiare më së shpeshti nënkuptohet bilanci,raportet mbi fitimin,raporti mbi ndryshimin e kryegjesë,raporti mbi rrjedhen e parasë si dhe shënimet e bashkangjitur të raporteve financiare.Prandaj,në procedurën e kryerjes së auditimit hulumtohen-kontrollohen së pari evidencat e kontabilitetit,e pastaj të gjitha evidencat tjera dhe kjo më së shpeshti prej kontabilistëve publik të autorizuar jashtë ndërmarrjes që kontrollohet.

Auditimi kështu i përshkruar ka të bëjë me auditimin ekstern të shkallës së lartë profesionale të raporteve financiare dhe në konceptin auditimi nënkuptohet pikërisht auditimi kështu i përshkruar.Me gjithat siq u theksua për shkak të kriteriumeve të ndryshme dallohen lloje të ndryshme të auditimit.

Në bazë të përshkrimit të tillë të auditimit mund të konkludohet,ashtu siq është theksuar,se objekti i auditimit të afarizmit të ndërmarrjes me theks në raportet financiare që burojnë nga ky afarizem.Bënë perjashtim dhe kjo vetëm ndonjëher,vetëm auditimi shtetror ku objekti i auditimit,përveq afarizmit të ndërmarrjeve publike dhe raporteve të tyre financiare dhe hulumtimit të mjeteve të buxhetit dhe fondeve të ndryshme për financimin e veprimtarive të intersit publik.

Afarizmi i ndërmarrjeve dhe raportet financiare të ndërmarrjeve janë objekt edhe i disiplinave tjera siq janë:ekonomiciteti i ndërmarrjeve ,kontabiliteti,afarizmi financiar ,analiza e afarizmit etj.

3

³ Marrë nga ligjërata Dr. Hysen Ismajli , Auditimi 2010
Wiliam F. Messier Jr,DBA ,CPA AUDITING ,McGRAW-HILL,INC

4.1. OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

Për një kuptim më të mirë ne mund të klasifikojmë objektivin e auditimit, si:

1. Objektivat parësore
2. Objektivat dytësore.

Objektivat primare: Të përcaktojë dhe të gjykojë besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe shënimet mbështetëse kontabël të një periudhe të caktuar financiare është qëllimi kryesor i auditimit. Fitimi dhe Humbja llogari dhe bilanc janë që tregojnë pamje të vërtetë dhe të drejtë të gjendjes së biznesit të kompanisë. Për të marrë një pamje të vërtetë dhe të drejtë të çështjeve të shoqërive dhe të shprehë mendimin e tij, ai ka për të tërësisht të kontrollojë të gjitha transaksionet dhe dokumentet përkatëse të kompanisë bëra gjatë periudhës së audituar. Cili do të ndihmojë auditorin që të raportojnë gjendjen financiare dhe rezultatin e punës së organizatës. Ndërsa kryerjen e procesit të auditimit, auditori mund të vijë të gjithë disa gabime dhe mashtrime. Por zbulimi i mashtrimeve apo gabimeve nuk janë objektivi primar i auditimit. Ata janë të ardhur nën objektivat dytësore të auditimit. Auditimi gjithashtu të ditur nëse Sistemi i Kontabilitetit miratuar në organizatë është adekuate dhe të përshtatshme në regjistrimin e transaksioneve të ndryshme, si dhe pengesave të sistemit.

Objektivat e mesme:

Në mënyrë që të raportojnë gjendjen financiare të biznesit, audituesi duhet të shqyrtojë librat e llogarive dhe të dokumenteve relevante. Në këtë proces ai mund të vijë nëpër mjet disa gabimeve dhe mashtrimeve. Ne mund t'i klasifikojmë këto gabime dhe mashtrime si më poshtë:

- 1 Zbulimi dhe parandalimi i Gabimeve
2. Zbulimi dhe parandalimi i mashtrimeve.

Zbulimi dhe Parandalimi i mashtrimeve: Për të marrë paratë e paligjshme nga organizata apo nga pronari mashtrime janë kryer me dashje dhe me pa dashje. Në qoftë se mbeten të

pazbuluara, ajo mund të ndikojë në opinionin e auditorit mbi gjendjen financiare dhe rezultatet e punës së organizatës. Prandaj, është e nevojshme për auditorin për të ushtruar kujdes maksimal për të zbuluar mashtrime të tilla. Ajo mund të jetë kryer nga drejtuesit e lartë ose nga punonjësit e organizatës. Mashtrimet mund të jenë nga llojet e mëposhtme:

1. Shpërdorimi i parave të gatshme
2. Shpërdorimi i mallrave
3. Falsifikimet ose Manipulimi i llogarive
4. Rregullim vitrinash
5. Rezervat Sekret

Shpërdorimi i Kash: Që pronari ka kontroll të kufizuar mbi pranimin dhe pagesave të parave të gatshme, shpërdorimit apo mashtrim të parave të gatshme është shumë e zakonshme posaçërisht në organizatat e biznesit të madh. Paraja mund të shpërdorohet nga mënyra të ndryshme, si të përmendura më poshtë:

- a. Incizim pagesat fiktive
- b. Incizim sasi më shumë se shuma aktuale e pagesës
- c. Pranimet e ndrydhura
- d. Incizim sasi më pak se shuma aktuale e pagesës.

Nuk duhet të ketë kontroll të rreptë të pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme të njohura si "sistem Kontrolli i brendshëm" për të parandaluar mashtrime të tilla. Audituesi duhet të kontrollojë librin e arkës me të dhënat origjinale, faturat regjistroheni, fatura, kupona, kupone apo libra dëftesë, fletët e pagave, ditar shitës-së, llogari bankare etj Në mënyrë për të zbuluar mashtrime të tilla.

-Shpërdorimi i mallrave: Kompanitë e trajtimit të mallrave me vlerë të lartë janë të lutet për këtë lloj të shpërdorimit. Pa regjistrime të duhura të aksioneve të brendshëm dhe të jashtëm, është e vështirë për auditorin të gjeni mashtrim të tillë periodik dhe kontrollin surprizë e stokut dhe mirëmbajtjen e duhur rekordin e lëvizjes brendshëm dhe të jashtëm të aksioneve mund të zvogëlojë mundësinë e mashtrimit të tillë.

-Falsifikimet ose manipulimin e llogarive: Në mënyrë që të arrijë objektivat e caktuara specifike, llogaritë mund të manipulohen nga ata persona të cilët janë përgjegjës në menaxhmentin e lartë të organizatës. Ata përgatisin llogaritë e një mënyre të tillë që ata të

hapen vetëm një foto jo të rreme foto e vërtetë. Disa nga mënyrat e përdorura në manipulimin e llogarive janë si më poshtë:

- Ekzagjerimit ose deflatuar shpenzimet dhe të ardhurat
- Shkrimi i borxheve të tepërta ose më pak e keqe.
- Vlerësimi mbi-apo nën-vlerësimin e stokut të mbylljes.
- Tarifimi amortizimin e tepërt ose më pak
- Akuzuar shpenzimet kapitale të ardhurave dhe anasjelltas
- Sigurimi për borxhet e tepërta ose më pak të dyshimta.
- Shitjes dhe blerjes ndrydhura ose duke treguar shitjet dhe blerjet fiktive etj

-Vitrinash: është mënyra e paraqitjes së të dhënave financiare në një pozitë shumë më të mirë sesa pozicionin origjinal. Ajo është e njohur si vitrinash. Disa nga arsytet për të bërë vitrinash janë si më poshtë:

- Për të fituar besimin e mbajtësve të aksioneve
- Për të marrë kredi të mëtejshme
- Për të rritur çmimin e aksioneve në treg duke paguar dividend më të lartë në mënyrë që aksionet e mbajtura mund të shiten
- Për të tërhequr parters ardhshëm apo aksionarëve.
- Për të fituar besimin e aksionerëve.

-Rezervat sekrete: Në rezervat sekrete, llogaritë janë përgatitur në mënyrë të tillë që ata të shpalosin pamje më keq se në të vërtetë atë që ata janë. Objektivat e përgatitjes së llogarive në këtë mënyrë janë:

1. Për të fshehin pozicionin e vërtetë nga konkurrentët.
2. Për të shmangur ose zvogëluar detyrimin tatimor

3. Për të zvogëluar çmimin e aksioneve në treg duke mos paguar dividend ose duke paguar dividend të ulët në mënyrë që aksionet mund të blihen me një çmim shumë të ulët.

Është shumë e vështirë për të zbuluar mashtrime të tilla që nga këto mashtrime janë kryer nga këta persona në organizatat që janë në pozitat e larta si drejtorëve, menaxherëve, kontrollorët financiarë etj për të zbuluar këto lloj mashtrime, auditori duhet të jetë vigjilent dhe duhet të bëjnë kërkim, kërkimet për të arritur në pozitën e vërtetë.¹⁴

¹⁴<http://iamsam.hubpages.com/hub/Definition-of-Auditing>

4.2 VLERËSIMI I NEVOJAVE PËR AUDITIM

Planet e auditimit të cilat janë të prodhuara si rrjedhim bazohen në një të kuptuar gjithëpërfshirës të organizatës dhe në aktivitetet e të gjitha departamenteve të tij. Vlerësimi i nevojave të auditimit duhet të sigurojë që aktivitetet e mëparshme të identifikuar me rrezik të lartë dhe fushat e njohura të vështirësisë janë identifikuar ndërsa përpjekjet e auditimit janë planifikuar si duhet. Procesi i vlerësimit të nevojave duhet të marrë në konsideratë çështjet më vijim:

- Identifikimi i të gjitha fushave të punës së analizuar nga sistemet, nënsistemet, establishmentet dhe lokacionet.
- Vlerësimi i nivelit të rrezikut dhe cenueshmërisë së secilës fushë të punës.
- Përcaktimi i periudhës përgjatë së cilës të gjitha sistemet dhe establishmentet do të auditohen dhe caktimi i shpeshtësisë së auditimeve individuale.
- Përcaktimi i burimeve të nevojshme për të përmbushur kërkesat e auditimit.
- Auditimi i bazuar në sisteme është një qasje e auditimit në të cilën auditori kërkon të sigurojë nivelin e kërkuar të sigurisë duke:
 - Të përcaktuarit se ekziston një sistem i efektshëm i përpunimit dhe regjistrimit të transaksioneve.
 - Vlerësimi dhe testimi i kontrolleve përkatëse të brendshme.

Kryerja e një niveli të reduktuar të mirëfilltë të testimit të pavarur

5

⁵<http://chinëeike.hubpages.com/hub/auditors>

5 LLOJET E AUDITIMIT

Kriteret për klasifikim të llojeve të auditimit

Autor të ndryshëm në mënyra të ndryshme klasifikojnë auditimin si p.sh

- 1.Vendi dhe personat që kryejnë auditimin
- 2.Subjektet që kryejnë auditimin
- 3.Objekti i cili mbikëqyret
- 4.Koha dhe përfshirja e sa kur kryhet auditimi.

Në literaturën Amerikane zakonisht nuk potencohen të gjitha llojet e auditimit,duke u bazuar në kriteret e ndryshme siq janë bërë edhe më parë më së shpeshti në këtë kontekst vlen të theksohet ndryshimet në mes të llojeve të ndryshme të auditimit andaj ato edhe klasifikohen në auditimin ekstern,auditimin shtetëror apo public,auditimin intern.

Duke i respektuar autor të ndryshëm me pretendim që numri dhe llojet e auditimit të dihen në numër më të ulët si dhe të theksohen ndryshime të theksuara në mes të llojeve të shumta të klasifikimit të disa llojeve të auditimit kriteret kryesore për klasifikimin e auditimit duhet të jenë:

Organi i cili kryen kontrollin,

Objekt i kontrollit,

Fusha e kontrollit.

Sipas organit i cili kryen kontrollin mund të klasifikojmë auditor ekstern dhe intern.

Sipas objektit të kontrollit klasifikohen në auditor të afarizmit dhe auditor te pasqyrave financiare.

Kriteri i fundit për klasifikim të llojeve të auditimit sipas fushave të kontrollit dallojmë auditorin komercial dhe auditorin shtetëror, siq mund ta shohim edhe në tabelë




Tabela 1. Llojet themelore të auditimit.....

5.1 AUDITIMI EKSTERN DHE INTERN

Auditimi ekstern

Auditimi Ekstern është procedurë e kontrollimit dhe vlerësimit të afarizmit të ndërmarrjes të cilën e kryejnë personat profesionist të pavarur dhe audior të licencuar. Ata nuk mund të jenë të punësuar në atë ndërmarrje si dhe nuk mund të kenë asnjë lidhje me atë ndërmarrje ku edhe kryhet auditimi sepse po të ishte e kundërta në atë mënyrë do të shkelej principi i pavarësisë së auditorit.

Me auditmin ekstern para se gjithashë nënkuptohet hulumtimi i realitetit të pasqyrave financiare të menaxhmentit nga pronësia, me zbatimin e këtij auditimi gjithashtu tentohet siq edhe u theksua më parë mbrojtja e interesit të pronarit të kapitalit, pastaj të sigurojnë informata të besueshme për menaxhmentin e ndërmarrjes.

Auditimi ekstern siq edhe u theksua më parë merret me auditmin e pasqyrave financiare, mirëpo mund të merret edhe me aktivitete të ndryshme siq janë: shërbimet e këshillimit, këshilla fiskale si dhe shërbime të ndryshme financiare etj.

Auditimi intern

Së bashku me auditimin e pasqyrave financiare është segment i rëndësishëm i auditimit si profesion në përgjithësi. Auditimin intern e zbatojnë personat e punësuar në ndërmarrje të cilët edhe e organizojnë dhe zbatojnë programin e auditimit intern, si test i përgjithshëm i ekzekutimit të gjitha aspekteve të kontrollit intern dhe afarizmit të ndërmarrjes .

Punët më të rëndësishme të cilat i kryen auditori intern në kuadër të ndërmarrjes janë hulumtimi organizimi si dhe zhvillimi në përmisimin dhe efikasitetin e disa funksioneve afariste, hulumtimin e mënyrës së marrjes së vendimeve afariste si dhe funksionimi i sistemit afarist dhe punët të tjera të cilat kryen në hulumtimin dhe vlerësimin e afarizmit të ndërmarrjes.

Për auditorin intern për dallim nga auditori ekstern më pak është me rëndësi shprehja e mendimit mbi realitetin dhe objektivitetin e pasqyrave financiare.

Me përcjelljen dhe angazhimin e punëve të auditimit intern më së shumti merren institutet e auditorëve intern i cili i pajisë me qertifikata për thirrje të auditorit intern të qertifikuar (Certified Internal Auditing)

5.2 AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE DHE I AFARIZMIT

Auditimi i pasqyrave financiare

Është procedurë e hulumtimit dhe vlerësimit të realitetit dhe objektivitetit të pasqyrave financiare . Kriteret për vlerësimin e objektivitetit dhe realitetit të pasqyrave financiare janë zakonisht dispozitat ligjore , pastaj principet e kontabilitetit dhe standardet e kontabilitetit. Ndërsa vetë procedura e vlerësimit zbatohet në përputhshmëri me standardet e auditimit (në kushtet tona ato sic u theksu pra standardet ndërkomëtare të auditimit).

Auditimi i pasqyrave financiare është segment më i rëndësishem i veprimtarisë së tërësishme të auditimit. Sipas rregullit auditimin e kryejnë shtëpitë e pavarura dhe profesionale të auditimit si dhe për këtë janë të qertifikuara që d.m.th se me auditimin e pasqyrave financiare më së shpeshti nënkuptohet auditimi ekstern , meqenëse për nevoja të menaxhmentit të ndërmarrjes, auditimin e pasqyrave financiare mund ta bëjnë edhe auditorët intern.

Në kontekst të auditimit të pasqyrave financiare , është me rëndësi si dhe e nevojshme të theksohet që metodologjia e përgjithshme e auditimit në kushtet bashkëhore është e bazuar në mostra (auditing sampling) . Megjithëse auditimi nuk i hulumton të gjitha rastet e transaksioneve mirëpo gjatë gjithë periudhës së caktuar kohore tentohet të zgjedhet vetëm një mostër representative ashtu që me hulumtimin e kësaj mostre të vije deri te njohja e përgjithshme e ndërmarrjes si dhe te njohja e pasqyrave financiare njëkohësisht vend të rëndësishëm zënë edhe procedurat analitike .

Auditmi i afarizmit

Prezanton hulumtimin dhe vlerësimin e afarizmit të përgjithshëm të ndërmarrjes (apo pjesëve të afarizmit) me qëllim të prosperimit të afarizmit të ndërmarrjes si dhe të suksesit të afarizmit (para se gjithash mendohet në rentailitet).

më se shpeshti që bëhet është se hulumtohet funksioni dhe organizmi i afarizmit, procesi i marrjes së vendimeve afariste, funksionimi i sistemit informative si dhe suksemi i afarizmit të ndërmarrjes në tëresi, auditimin e afarizmit më së shpeshti e zbatojnë auditorët intern. Ky lloj i auditimit duhet të vëzhgohet ndaras nga auditimi i pavarur i pasqyrave financiare, mirëpo kjo nuk d.m.th. që auditimin e afarizmit nuk mund ta zbatojnë auditorët ekstern, në mes të auditorit inten dhe ekstern ekzistojnë elemente të përbashkëta por edhe veqohen nga njëra tjetra.

Për shkak të drejtimit të auditimit të afarizmit para se gjithash për nevoja të menaxhmentit të ndërmarrjes në kushtet bashkëkohore ajo gjithnjë e më tepër thirret edhe auditimi i menaxhmentit (auditing management) qe gjithnjë e më tepër drejtohet kah caqet e ndërmarrjes duke u përputhur me politikat e aprovuara të ndërmarrjes.

5.3 AUDITIMI KOMERCIAL DHE SHTETËROR

Auditimi komercial

Auditimi komercial është term që zakonisht përdoret për auditimin ekstern, të pavarur. Auditimi ekstern kryhet në bazë të kontratës e cila lidhet në mes të obilitesit të auditimit dhe kompanisë e cila mirret me auditim, kontrata lidhet me shkrim për qdo vit. Me këtë kontratë rregullohen marrëdhëniet ndërmjet vete si dhe kushtet e pagesës. Kompania e auditimit duhet të sigurohet prej përgjegjesisë nga dëmi nga e cila mund të shkaktohet nga pakujdesia gjatë kryerjes së punës së auditimit. Nënkuptohe që kompania është anëtare e shoqatave profesionale që merren me auditimin apo dhe insituteve të ndryshme të auditimit si dhe nënkuptohe që ato i zbatojnë standardet e auditimit dhe kodin e etikës etj.

Më së shpeshti sistemi i organizimit të ndërmarrjeve është në formë të partneritetit e cila ka pra autorizim të mbikëqyr ndërmarrjen në punën e vet, në shumicën e rasteve me ndërmarrjen që menagjojnë janë personat që e kanë dhënë provimin adekuat dhe kanë titullin auditor i qertifikuar. Për shkak të pavarësisë së ndërmarrjes konsiderohet se të ardhurat prej një klienti (obliguesi të auditimit) nuk guxojnë të jenë më tepër se 15% e të ardhurave të përgjithshme në bazë të auditimit, mund të thuhet se ndërmarrjet e auditimit janë organizata gjysmë profitabile gjegjësisht profitin nuk është në rend të parë, kjo natyrisht nënkupton që auditimi nuk paguhet mirë se si profesionist konsiderohet se sikur të realizohet profiti apo të maksimalizohet, atëherë ajo do të shërben apo do të bie edhe deri të shmangja nga kodi etik.

Pa marrë parasysh në kufizimet të përcaktuara ndërmarrjet e auditimeve afarohet si thënë më lart në baza komerciale dhe në këtë kuptim mund të quhet komerciale. Ndërmarrja e auditimit mund të merret edhe me aktivitete të tjera, mund që njëkohsisht të kryej edhe punët e auditimit si dhe në anën tjetër të kryej aktivitetet tjera psh. Rolin e këshilldhënësit. Mirëpo është mirë të theksohet se nocioni i auditimit komercial më shpesh nënkupton auditimin e pasqyrave financiare.

Në këtë kontekst është me rëndësi të theksohet pyetja e rrezikut të auditimit “rreziku i auditimit dmth. Rrezik që auditori të shpreh mendim të pa përputhshëm kur pasqyrat financiare janë treguar mjaftë të gabuara”. Rreziku i auditimit përbëhet prej tri llojeve të

auditimit rrezikut inherentë, rrezikut të kontrollit dhe rrezikut të moszbulimit. Nënvizohet se auditimi komercial rrjedh prej asaj se para se gjithash prej kompensimit që pason në bazë të kontratës për kryerjen e auditimit, mirëpo edhe për përgjegjësin material që mund të del eventualisht nga dëmi i bërë gjatë kryerjes së auditimit.

Auditimi shtetëror (government auditing)

Kryhet në emër të shtetit dhe në llogari të shtetit, këtë lloj të auditimit e kryen zyra e shtetit për auditim. Kjo nënkupton që zyra e shtetit për auditim është eksterne e pavarur, pra është zyre profesionale. Në kushtet tona, auditimi shtetëror rregullon të hyrat, të dalurat, auditimin e pasqyrave financiare, dhe transaksionet financiare të njësive të sektori shtetëror, njësive lokale qendrore gjegjësisht agjensionet që financohen nga shteti etj.

Gjithashtu me auditim shtetëror nënkuptohet hulumtimi i dokumenteve, raporteve, sistemit të kontrollit intern dhe auditimi intern, procedurat kontabile dhe financiare si dhe evidenca të tjera më qëllim të konstatimit të pasqyrave financiare ato tregojnë pozitën financiare të vërtetë si dhe rezultatet e aktiviteteve financiare të janë në përputhshmëri me principet e kontabilitetit dhe të standardeve të kontabilitetit. Kjo është edhe procedurë e hulumtimit të transaksioneve financiare të cilat prezantojnë të hyrat dhe të dalat shtetërore në kuptimin e shfrytëzimit të mjeteve në pajtim me dispozita ligjore.

Auditimi gjithashtu përfshinë edhe dhënjen e vlerësimit mbi ekonominë dhe efikasitetin si dhe realizimin e caqeve të parapara në program.

Pra sipas kësaj objektivii këtij lloji të auditimit janë.

1. Mjetet prej fondeve të ndryshme për financimin e veprimtarisë që janë me interes publik
2. Mjete prej ndërmarrjeve publike
3. Mjete të huazimeve publike
4. Mjetet e solidaritetit
5. Mjetet e tjera të mbledhura të destinara për nevoja publike.

Kriteret për vlersimin e rregullsis së pasqyrave financiare edhe te ky auditim janë më shpesh principe të kontabilitetit, standard të kontabilitetit, si dhe të gjitha ligjet dhe procedurat relevante, ndërsa procedurat e auditimit kryhen në përputhshmëri me standardet specifike të auditimit shtetëror apo publik. Në këtë kontekst mund të flitet mbi të

ashtuquajturën “INTOSAI” standard të auditimit të cilat janë miratuar nga organizata ndërkombëtare prestigjioze të standardeve të auditimit (International organization of supreme audit institutions)

Në praktikën amerikane auditimi shtetëror pro publik zbatohet në përputhshmëri me standarde të pranuar shtetërore të auditimit të njohura si (Generally accepted government auditing standards-GAGAS).

Me standardet e auditimit shtetëror kërkohet që auditori me shumë kujdes të përkushtoj zbatimin efikas të afarizmit si dhe të përcjell realizimin e programit të paraparë.

Pëveq kësaj, zakonisht kujdes të veçantë i kushtohet edhe shfrytëzimit të mjeteve dhe dedikimit të tyre të karakterit publik si dhe mbi realitetin dhe objektivitetin e pasqyrave financiare. Ky lloj i auditimit nuk ka karakter komercial, për arsye se puna e zyrës së auditorit të shtetit financohet nga vet ai.

Në kushtet tona auditimin shtetëror mund të kryejnë vetëm personat të cilët kanë titull apo thirrje “Auditori Certifikuar Shtetëror” për të cilat përveq tjerash, është e nevojshme të kete përvoj adekuate si dhe dhënien e provimit gjegjës. Gjatë kryerjes së punës së auditimit , auditori shtetëror duhet sikurse auditoret komercial ti përmbahen kodit etik të auditorit siq është cekur te standardet e auditimit për auditimin shtetror.

5.4 PARIMET BAZË TË PRINCIVEVE TË AUDITIMIT

Parimet bazë të principeve të auditimit

Principi i etikës profesionale – Nënkupton që auditori me punën e vet duhet t’u përmbahet rregullave të përcaktuara të mirësjelljes, kështu që të mbroj auditmin si profesion nga sjellja e disa auditorëve të cilët me veprimet e tyre përfshijnë imazhin dhe profesionin. Në këtë kontekst bien kodet nacionale të etikës profesionale të cilat përmbajnë rregullat e obligueshme mbi sjelljen e auditorëve.

Parimi i pavarësisë – është njëri prej parimeve kryesore në kushtet bashkëkohore ,në këtë princip kërkohet që auditori për kryerjen e punës së vet duhet të jetë i pavarur. Auditori gjithashtu duhet të jetë plotësisht i pavarur në planifikimin e procesit të auditimit si dhe duhet t’iu përballoj kërkesave të menaxhmentit të ndërmarrjes të cilat shpeshherë dëshirojnë të kufizojnë auditimin vetëm në disa aspekte të punës .

Parimi i profesionalizmit dhe kompetentësisë –kërkon që përveq normave të tyre morale ,duhet të ketë edhe disa njohuri dhe shkollim profesional të cilat mundësojnë që në mënyrë kualitative të kryejnë punën e auditorit si dhe të ketë përvojë dhe praktikë në lëmin gjegjëse.

Parimi i përgjegjësisë –obligon që auditori në përcaktimin e përgjegjësisë gjatë lëshimit eventual të punëve duhet të jenë përgjegjës për punën e vet.

Parimi i dokumentaritetit –klasifikohet në principe më të vjetra të auditimit si dhe në lidhshmëri të ngushtë është me principin e kontabilitetit të rregulltë në këtë kontekst konsiderohet secili ndryshim në punë duhet të ketë edhe dokumentacionin përcjellës. Përveq kësaj në kushtet bashkëkohore principi i dokumentaritetit nënkupton edhe atë që puna e

auditorit duhet të bazohet në fakte të cilat janë të dokumentuara në fletorën e punës së auditorit .

Principi i raportimi korrekt –obligon që të përmbahet nga dhënia e mendimit kur për atë nuk ofron mundësi tjera ,apo do të dëmtoj punën e mëtejshme.Shpeshherë pengesa më e madhe për shprehjen e mendimit është pamundësia e qasjes nëdokumentet e nevojshme ,kufizimin në dokumentet e rëndësishme etj .Mendimi i auditorit është pjesë përbërëse por edhe më e rëndësishme gjatë raportimit të auditorit mbi realitetin dhe objektivitetin e pasqyrave financiare.

⁶ Rich Hayes,Arnold Schilder ,Roger Dassen ,Philip Wallage,PRINCIPLES OF AUDITING

6 BENEFITET E AUDITIMIT

Çdokush i cili ka një numër të personelit, funksioneve, lokacione të zyrave ose sisteme teknike që ai / ajo nuk është personalisht dhe operues i vetëm, mund të tejkalojë rrezikun e gabimeve apo parregullsive që ndodhin në biznesin e tyre. Është gjithashtu e dëshirueshme për të kontrolluar dhe parandaluar mashtrimin duke kryer një kontroll të rregullt.

- Një auditim ndihmon për të identifikuar dobësitë në sistemet e kontabilitetit dhe na mundëson që të sugjerojmë përmirësime. Procesi i tillë i mbanë të informuar partnerët e zonave / situatat ku këshilla është e dobishme;
- Një auditim siguron drejtorë të cilët nuk janë të përfshirë në funksionet e kontabilitetit në një bazë ditë-për-ditë që tregojnë se biznesi është duke u zhvilluar në përputhje me informacionin që ata janë duke e pranuar, dhe ndihmon në zvogëlimin e fushës për mashtrim dhe kontabilitet dobët;
- Një auditim lehtëson ofrimin e këshillave që mund të ketë përfitime reale financiare për një biznes, duke përfshirë rrjedhën e zhvillimit të biznesit, çfarë kufijë mund të arrihen dhe se si mund të arrihen. Këshilla mund të mbulojë çdo gjë nga shtrëngimi i kontrolleve të brendshme, për të zvogëluar rrezikun e mashtrimit apo planifikimin e taksave;
- Një auditim do të rrisë kredibilitetin dhe besueshmërinë e shifrave të paraqitura të blerësve të ardhshëm. Nëse një menaxher pronar është duke planifikuar mbi shitjen në 3 vitet e ardhshme, ajo mund të jetë e dobishme për të kryer auditime të rregullta;
- Një auditim mund të jetë i dobishëm në qoftë se një kompani është në rritje dhe ka të ngjarë të kalojë pragun e qarkullimit në të ardhmen e afërt, në mënyrë që të shmang rishqyrtimin e shifrave të viteve të mëparshme, pasi pragu është arritur;
- Një auditim shton kredibilitetin e informatave të publikuara për punonjësit, klientët,

furnizuesit, investitorët dhe autoritetet tatimore;

- Auditimi ofron siguri për aksionarët (në qoftë se ata nuk janë drejtorë të përfshirë ngushtë në biznesin) se shifrat në llogari tregojnë një pamje të vërtetë dhe të drejtë;⁷

6.1 AUDITORET E BRENDSTEM

Auditorët e brendshëm fokusohen në kontrollet e brendshme brenda organizatës për të siguruar sigurinë e aseteve; saktësia dhe besueshmëria e regjistrave; ekonomia, efienca dhe efektshmëria e operacioneve dhe ajo që organizata është në përputhje me legjislacionin, rregulloret dhe direktivat e tjera. Pse kryhen auditimet e brendshme?

Për të raportuar në mënyrë të pavarur tek menaxhmenti lidhur me përshtatshmërinë e kontrolleve të brendshme si një kontribut për përdorimin e duhur, ekonomik, efikas dhe të efektshëm (3 E-të) të burimeve.

Çfarë bëjnë auditorët e brendshëm?

Ata ekzaminojnë në mënyrë objektive dhe vlerësojnë sistemin e kontrollit të brendshëm si një shërbim për organizatën. Auditimi i Brendshëm synon të ndihmojë organizatat e sektorit publik të arrijnë objektivat e tyre nëpërmjet veprimtarisë së pavarur objektive dhe të bazuar në risk, dhe përfshin:

I. Mbështetjen e organizatës për të arritur qëllimin e saj, duke:

- a. Ndihmuar titullarin të identifikojë dhe të vlerësojë risqet në organizatë;
- b. Vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e: sistemeve, strukturave, vendimeve, procedurave dhe kontrolleve, pra sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në përgjithësi, duke u fokusuar kryesisht në:

- identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i organizatës;
- përputhshmërinë e akteve të brendshme dhe të kontratave me legjislacionin;

- besueshmërinë dhe gjithpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;
- kryerjen e veprimtarive me kursim, dobi dhe frytshmëri; ruajtjen e aseteve dhe të informacionit; dhe
- përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve.

II. Mbështetjen e angazhimeve/kryerjen e detyrave të veçanta të auditimit për dhënien e shërbimeve të sigurisë ose të shërbimeve të këshillimit.

Vizioni i Auditimit të Brendshëm është *t'i shtojë vlerë organizatave të sektorit publik në Shqipëri duke siguruar përdorimin me dobi, kursim dhe frytshmëri të fondeve publike.*

6.2 AUDITORËT E JASHTËM

Auditorët e jashtëm gjithashtu fokusohen në të njëjtat fusha por në mënyrë primare interesohen në krijimin e opinionit të tyre lidhur me atë nëse ose jo llogaritë e organizatës paraqesin një fotografi të aktiviteteve të saj dhe që organizata vepron vetëm brenda fuqive të saj detyrimore (Rregullsia). Auditimi i bazuar në sisteme mund të ndihmojë këtë duke rishikuar fuqinë e kontrolleve të brendshme, duke u siguruar që bilancet dhe transaksionet janë materialisht të sakta. Auditimi i jashtëm është një ekzaminim i pasqyrave financiare të një organizate të sektorit privat ose publik përmes një pale të tretë të pavarur, p.sh. auditorit të jashtëm.

Pse kryhen auditimet e jashtme?

Për të mundësuar auditorët e jashtëm të publikojnë një mendim lidhur me pasqyrat financiare që i nënshtrohen auditimit.

Ofrimi i sigurisë së arsyeshme lidhur nëse pasqyrat financiare të marra në tërësi janë pa keqdeklarime materiale, p.sh. janë të plota, të sakta dhe të vlefshme.

Çfarë bëjnë auditorët e jashtëm?

Të jenë në përputhje me standardet e aplikueshme të auditimit.

Ekzekutimi i procedurave të dizajnuara për të siguruar dëshmi të mjaftueshme të auditimit për të përcaktuar nëse pasqyrat financiare janë pa keqdeklarime materiale dhe janë përgatitur në pajtim me legjislacionin përkatës dhe me Standardet Kontabël.

7 PËRFITIMET DHE AVANTAZHET E AUDITIMIT

Përfitimet enjë auditimijanë të shumta. Auditimimund të përmirësojëefikasitetine një kompanie dheprofitabilitetinduke ndihmuartë kuptojmë më mirërreth menaxhimittë punësdhe sistemeve të tyrefinanciare. Menaxhmenti, si dheaksionarët,furnizuesit dhefinancuesit, janëgjithashtu të sigurt serrezizqetnë organizimin e tyrejanë të mirë-studiuar, dhe sistemetefektivejanë në vendpër të trajtuar ato.

Auditimetgjithashtu mund tëidentifikojnë fushatnëstrukturën financiarete organizatës që kanë nevojë përpërmirësim, dhe si të zbatojndryshimet dhe rregullimet e duhura.Duke pasur njëauditimgjithashtuzvogëlonrrezikun dhe kostone kapitalit.

Një auditimmund të zbulojëpasaktësitëdhe mospërputhjetbrendaregjistravetë organizatës, të cilat mundtë jenë indikacionetë organizimit tëdobët financiarose mashtrimmadje edhetë brendshme,edhe psebulimi i mashtrimevenuk ështëqëllimi kryesor injë auditimi.

Përfitimet enjë auditimi:

- Analiza dhe tëkuptuarit e shënimevefinanciare tëkompanisë suaj.
- Të identifikohen fushatkyçe përpërmirësim nëkompaninë tuaj.
- Të vlerësojë rrezizqet, ekonominë, efikasitetin dhe cilësinë.
- Vlerësoniteknologji të re.
- Për të zbuluarveprimtari mashtrueseose të tjeratë paligjshmebrenda kompanisë suaj.
- Fuqizimidhe forcimin ekontrollit të brendshëm.

Auditorëtkanë njëperspektivë uniketë gjerë tënjë kompanietë cilën ata e aplikojnëpër të

⁸⁸<http://ëëë.kingstonsmith.co.uk/services/accountancy-and-audit/benefits-of-audit/>

ofruar analiza efektive dhe informacionin përkatës. Menaxhmentimund ta përdorkëtë informacionpër të vlerësuar kompaninë dhe të zbatojnë masat e nevojshme për të përmbushur objektivat e tyre.⁹

⁹<http://ëëë.auditing.arollo.com/benefits.html>

8 DISKUTIME DHE PËRFUNDIME

Të gjithë tani dimë për skandalet e mëdha financiare të viteve të fundit si Enron e Worldcom në SHBA dhe së fundmi Parmalat në Itali. Secili nga këto skandale u shoqërua me pasoja katastrofike për punonjësit, aksionerët dhe kreditorët e shoqërive në fjalë, si dhe për ekonominë e vendeve ku ato kishin pjesën më të madhe të aktiveve. Shumë mashtrimet financiare që drejtuesit e këtyre kompanive kishin realizuar, kishin shumë vite që kryheshim në fshehtësi dhe aksionerët, e kreditorët e palët tjera të interesuara nuk ishin aspak në dijeni mbi dëmin që po iu shkaktohej. Në të gjitha rastet, mashtrimet ishin rezultat i një mosfunksionimi të drejtë të qeverisjes së këtyre kompanive (Corporate Governance). Qeverisja e kompanisë është e përkufizuar si – sistemi me të cilin shoqëritë drejtohen dhe kontrollohen. Struktura e qeverisjes së kompanisë përcakton shpërndarjen e të drejtave dhe përgjegjësi ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm në kompani si bordi, drejtuesit, aksionerët dhe palë të tjera të interesuara, si dhe detajon rregullat e procedurat për marrjen e vendimeve në kompani. Nëpërmjet këtij mekanizmi përcaktohet struktura që vendos objektivat e shoqërisë, si dhe sigurohen mjetet përmes të cilave këto objektiva mund të arrijnë rezultate, të cilat mund të monitorohen (OECD Principles on Corporate Governance 1999). Dy faktorë të rëndësishëm që sigurojnë një qeverisje të shëndoshë të kompanive, janë Auditimi i Brendshëm dhe Auditimi i Jashtëm.

Auditimi jashtëm ka dështuar shpesh në identifikimin e rasteve të mosfunksionimit të qeverisjes së kompanive dhe ndonjëherë edhe me pasoja fatale dhe për vetë shoqëritë e auditimit. Të kujtojmë skandalet e mëdha që ndodhën e që shkaktojnë shkrirjen e Arthur Andersen, një nga pesë kompanitë më të mëdha të auditimit në botë. Auditorët e jashtëm mundohen të kufizojnë riskun e dështimit të auditimit përmes klauzolave shtesë në kontrata që i mbrojnë ata nga risku. Kompanitë e auditimit në përgjithsi nuk e quajnë veten përgjegjëse për qeverisjen e kompanive, të gjithë ne e dimë që qëllimi i Auditimit të jashtëm është të mundsoj auditorin të jap një opinion, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet thelbësore në përputhje me kuadrin e caktuar të raportimit financiar – Standardet ndërkombëtare të Auditimit (ISA 200)

Nga qëllimi i vetë auditimit të jashtëm mund të shohim që ai është fokusuar në dhënien e një opinionimi mbi pasqyrat financiare. Kjo sigurisht e kufizon kontributin që ai ka në një qeverisje të shëndoshë të kompanisë. Në të kundërt, përgjegjësia kryesore mbi qeverisje të shëndoshë të kompanisë bie mbi komitetin e auditimit të Auditimit dhe bordin drejtues. Pikërisht për të arritur një qeverisje të shëndoshë të kompanisë, si dhe për të mbrojtur interesat e të gjitha palëve të interesuara në aktivitetin e shoqërisë, këto dy organe mbështeten mbi punën e auditimit të brendshëm.

Cila është situata në tregun shqipëtar? Për të dhënë një ide më të qartë të situatës në tregun shqipëtar unë po mundohem ta trajtoj në aspektin e kuadrit rregullator, d.m.th. atë të praktikës së ndjekur kryesisht nga kompanitë shqiptare. Kuadri rregullator është e rëndësishme të sqarohet në lidhje me shqiptarë nuk ka asnjë referencë për standardet e Auditimit të brendshëm ose të ketë kërkesa specifike ndaj kompanive, si atyre të regjistruara si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe atyre të regjistruara si shoqëri anonime për egzistencën e një departamenti të auditimit të brendshëm. Përsa i përket shoqërive me përgjegjësi të kufizuara ligji nuk kërkon krijimin e një komiteti auditimi dhe nuk ka asnjë kërkesë për funksionimin e auditimit të brendshëm ndërsa kompanive të regjistruara si shoqëri anonime u kërkohet të kenë një këshill mbikqyrës. Në vendin tonë ndër kompanitë, Bankat janë padyshim më të përparuarat në këtë drejtim, megjithatë buxheti që jepet auditimit të brendshëm akoma mbetet shumë i vogël. Ndërmarrjet shoqërore shtetërore, sidomos ato më të mëdha kanë auditor të brendshëm. Megjithatë numri i tyre është mjaft i kufizuar krahasuar me riskun që këto ndërmarrje mbartin në aktivitetin e tyre. Ndërmarrjet private sidomos ato që nuk kanë pjesëmarrje nga investitorë strategjikë, kanë një mungesë totale të auditimit të brendshëm. Si përfundim mund të themi se Kuadri rregullator në vendin tonë si për qeverisje ashtu edhe për funksionimin e ndërmarrjeve Auditimi i brendshëm është shumë i mangët, praktika e auditimit është e kufizuar si dhe ato pak ndërmarrje që kanë adresuar qështjen e ndërtimit të një auditimi të brendshëm e kanë bërë duke dedikuar pak burime financiare për këtë funksionim. Në asnjë rast nuk ka një proces të formatizuar për identifikimin e risqeve të kompanisë dhe kryerjen e procedurave të auditimit për mbulimin e këtyre risqeve.

9 REFERENCAT

Ligjërata Dr. Hysen Ismajli , Auditimi 2010

Gilbert E. Joseph and Terry J. Engle (December 2005).
["The Use of Control Self-Assessment by Independent Auditors"](#)

[^"Audit assurance"](#).

Eiliam F. Messier Jr, DBA , CPA AUDITING , McGRAE-HILL, INC

<http://iamsam.hubpages.com/hub/Definition-of-Auditing>

<http://chinëike.hubpages.com/hub/auditors>

Rich Hayes, Arnold Schilder , Roger Dassen , Philip Eallage, PRINCIPLES OF
AUDITING

<http://ëëë.kingstonsmith.co.uk/services/accountancy-and-audit/benefits-of-audit/>

<http://ëëë.auditing.arollo.com/benefits.html>
